



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:192534
Datë: 18.09.2024
Numri i dokumentit: 06178381

C.nr.296/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Byroja Kosovare e Sigurimeve - BKS nga Prishtina, Rruga "L. e P." p.n., të cilin e përfaqëson e autorizuar Gentiana Ahmeti, me autorizim, kundër të paditurit K. (Xh.) Xh. nga fshati Ll., Komuna e Podujevës, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm B. S., avokat nga Podujeva, Rruga "B. F." p.n., baza e kontestit për Rimbursim dëmi, kontesti në vlerë prej 2,917.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të mbajtur në prani të palëve ndërgjyqëse të autorizuarit të paditëses dhe përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit, me datën 05.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) nga Prishtina, Rruga "L. e P.", pn., **si e bazuar**.

DETYROHET i padituri K. (Xh.) Xh. nga fshati Ll., Komuna e Podujevës, që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve nga Prishtina, Rruga "L. e P.", pn., t'ia kompensojë shumën prej 2,917.00 (dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar të dëmtuarve (E. Gj., Policia e Kosovës, N. F.) në aksidentin e datës 14.07.2016 në Podujevë, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, po ashtu t'i paguaj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 460.40 €, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve nga Prishtina, Rruga "L. e P.", pn., sa i përket kamatës që kamata të jetë nga dita e ngritjes së padisë, në tërësi **si e pabazuar**.

A r s y e t i m

Paditësja, me datë 27.05.2019, ka ushtruar padi në këtë gjykatë me të cilën ka kërkuar që të aprovet kërkesëpadia e paditëses dhe ta detyrojë të paditurin e lartcekur, t'ia bëjë rimbursimin e dëmit në vlerë prej 2,917.00 Euro.

Ka shtuar se i padituri me datën 14.07.2016, rreth orës 16:40 në Podujevë ka shkaktuar aksident trafikun, me automjetin VW, me targa të regjistrimit-EK. Deri te aksidenti ka ardhur kur automjeti "A" të cilin e drejtonte tani K. Xh., i cili nga pakujdesia i shkakton dëme të dëmtuarit S. Xh., E. Gj., Policia e Kosovës dhe N. F.. Automjeti i cili ishte shkaktar i këtij aksidenti në momentin e shkakimit të tij ka qenë pa mbulesë sigurorese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Si rezultat i këtij aksidenti të dëmtuarit S. Xh., E. Xh., Policia e Kosovës dhe N. F., paditësja në respektim të LSDA nr. 04/L-018 dhe LMD-së i ka kompensuar dëmin material dhe jo material të pësuar si rezultat i aksidentit. Tutje thekson se paditësi në procedurën jashtëgjyqësore ju ka drejtuar të paditurit, por nuk kemi mundur që këtë çështje ta mbyllim, andaj në respektim të dispozitave të LSDA Nr.04/L-018 neni 18 par.1 ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet i padituri që në emër të rimbursimit të dëmit t'ia paguaj paditësit shumën e kërkesës prej 2,917.00 Euro, me kamatë ligjore, duke llogaritur nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare si dhe ti paguaj shpenzimet e procedurës të cilat do ti caktoj kjo gjykatë në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Më tej ka shtuar se nga administrim i provave konsiderojmë se është arsyetuar apo vërtetuar mjaftueshëm përgjegjësia e të paditurit karshi dëmit të shkaktuar, ku nga ky aksident BKS përmes fondit të kompensimit ka kompensuar të dëmtuarit.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovohet në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të bazuar, ashtu që të obligoj të paditurin që ta kthejë borxhin në emër të rimbursimit të dëmit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto me kamatë ligjore nga dita e ngritjes së padisë e deri në ditën e pagesës përfundimtare.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës, në të përgjigjur në padi, në seancë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e konteston padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa mbështetur në prova konkrete. Ka shtuar se duke i analizuar shkresat e lëndës shohim se nuk kemi ekspertizë të pavarur e cila vërteton lartësinë e dëmit të kërkuar nga ana e paditësit, përkatësisht vlera e kontestit e cila konsideroj se është e lartë.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që të refuzohet padia e paditëses si e pa bazuar në prova konkrete. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas tarifës së TOAK-së.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: u lexua Transferi nga kontoja me numër lëshuar nga Banka Ekonomike me dt.30.12.2016, Ujdia Jashtëgjyqësore e lidhur në mes të BKS dhe E. Gj. me dt.25.11.2016, Raporti Policorë numër 2016-AR-.... dt.14.07.2016 së bashku me Skicën e vendit të ngjarjes nr. 2016-AR-.... dt.14.07.2016, Udhëzim nga konsullata me numër lëshuar nga QKUK Prishtinë për E. Rr. dt.28.07.2016, Raporti nga konsulta numër për E. Rr. dt.28.07.2016, Raporti nga konsulta numër për E. Rr. dt.28.07.2016, Raporti nga konsulta numër protokolli ... për E. Rr. dt.18.07.2016, Raporti nga konsulta numër për E. Rr. dt.28.07.2016, Raporti nga konsulta numër protokolli ... për E. Rr. dt.28.07.2016, Raporti nga konsulta numër për E. Rr. dt.18.07.2016, Raporti nga konsulta numër protokolli .. për E. Rr. dt.19.07.2016, Raporti nga konsulta numër ... për E. Rr. dt.18.07.2016, Raporti nga konsulta

numër protokollit .. për E.Rr. dt.19.07.2016, Udhëzim nga konsullata me numër .. lëshuar nga QKUK Prishtinë numër .. për E. Rr. Raport nga Konsulta numër protokollit .. dt.21.07.2016, Analiza Biokimike, Raporti specialistit lëshuar nga Ordinanca Specialistike ortopedike O. numër protokollit2016 dt.02.08.2016, Raporti lëshuar nga QKUK – Qendra Emergjente Prishtinë nr. protokollit, Konfigurimi i sigurimit TPL:... dt.14.03.2013, Transferi nga kontoja numër lëshuar nga Banka Ekonomike me dt.21.04.2017, Ujdia Jashtëgjyqësore e lidhur mes BKS dhe N. F. me dt.17.03.2017, Vendim lëshuar nga Policia e Kosovës me numër reference 07/1-01A..... dt.22.08.2016, Raport Specialistik lëshuar nga Ordinanca specialistike N. dt.19.07.2016 për N. F., Raport nga Konsulta numër protokollit dt.18.07.2016, për N. F., Raporti nga konsulta numër ... për N. F. dt.18.07.2016, Raport nga Konsulta numër protokollit ... dt.22.07.2016 për N. F., Raport nga Konsulta numër ... për N. F., Raport nga Konsulta numër 007386 për N. F., Raport nga Konsulta numër te protokollit dt.22.07.2016 për N. F., Raport nga Konsulta numër dt.14.07.2016 për N. F., Raport nga Konsulta numër ... dt.14.07.2016 për N. F., Raporti specialistik lëshuar nga Ordinanca Specialistike ortopedike O. numër protokollit .../2016 dt.28.07.2016, Raporti specialistit lëshuar nga Ordinanca Specialistike ortopedike O. numër protokollit ../17 dt.04.01.2017, Raporti lëshuar nga QKUK Qendra Emergjente në Prishtinë, për N. F., Transferi nga kontoja m numër lëshuar nga Banka Ekonomike me dt.10.07.2017, Ujdia Jashtëgjyqësore e lidhur mes BKS dhe Policia e Kosovës nga Prishtina me dt.27.06.2017, Fotot e veturës se dërmuar në aksident, Fatura numër .../08/16 dt.23.08.2016, lëshuar nga PPZ Fatosi, Konfirmimi i sigurimit kasko, dt.15.06.2016 deri me dt.14.06.2017, lëshuar nga KS S.” Kërkesa për kompensime (riparim) te demit dt.10.08.2016, Memorandumi Zyrtar dt.28.07.2016, Memorandumi Zyrtar dt.27.07.2016, Kallëzim Penal me numër te rastit 2016-AR-1762 dt.14.07.2016, Deklarata e shoferit dhen ne Policin e Kosovës dt.14.07.2016, Informacionet rrethe veturës, Raporti i oficerit për E. Gj., dt.18.07.2016, Raporti i oficerit për N. F. dt.18.07.2016, Deklarata e Vozitësit N. F. dhe ne Policin e Kosovës dt.16.07.2016, Certifikata e regjistrimit te automjetit CRA.....6 ne emër te Polica e Kosovës me targa te regjistrimit numër Policia-....-02, Polica e Sigurimit lëshuar nga KS “S.” dt.10.06.2016, Aktvendim me numër C.nr.296/2019 me te cilin ftohet paditësja qe te bej rregullimin e padisë me adresën e saktë të paditurit dt.24.11.2023, Parashtrësë e paditëses e dt.24.01.2024, Aktvendim C.nr.296/2019 me te cilën është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit dt.24.01.2024, Shpallja me te njëjtin numër dhe datë, përkthyer ne gjuhën Angleze nga përkthyesi Gjyqësor She. Z. dhe në gjuhën Serbe nga përkthyesi Gjyqësor Sh. Z., njoftimi nga gazeta Zyrtare e RKS mbi publikimin e Aktvendimit për caktimin e përfaqësuesit te përkohshëm të paditurit dt.24.04.2024, Procesverbal i dt.05.06.2024, Ekspertiza e Komunikacionit e hartuar nga eksperti S. Sh. dt.09.07.2024.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Meqenëse, ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë për sa i përket shkaktarit dhe kontributit të pjesëmarrësve në shkaktimin e aksidentit, gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditëses me qëllim të eliminimit të dilemave dhe vërtetimit të shkaktarit të aksidentit dhe

kontributit të pjesëmarrësve në aksident nxori provën me ekspertizën e komunikacionit e hartuar nga ana e ekspertit gjyqësor Ing. S. Sh., ekspert i komunikacionit të dt.03.07.2024, i cili në konstatimin dhe mendimin e tij, në bazë të materialit të dhënë në shkresat e lëndës ka ardhur në përfundimin se:

Në bazë të shkresave në lëndës, aksidenti i trafikut rrugor ka qenë përplasje e automjetit “A” me pjesën e përparme në pjesën e prapme të automjetit “B” e për pasojë janë shkaktuar dëme materiale dhe lëndime trupore. Të dy automjetet po lëviznin në të njëjtën kahe, nga drejtimi i Prishtinës në drejtim të Podujevës, ashtu që në vendin e quajtur “Qershiat e Ll.” derisa automjeti “B” ishte para automjetit “A”, ky i fundit përplaset me automjetin “B”. Drejtuesi i automjetit “A” në momentin kritik ishte duke lëvizur në shiritin e djathtë të trafikut dhe po lëvizte me shpejtësinë rreth 47km/h. Automjeti “B” ishte duke lëvizur në shiritin e djathtë të trafikut dhe para tij ishte krijuar kolonë e automjeteve e cila ishte ndalur në rrugë apo lëvizte ngadalë, drejtuesi i automjetit “B” e zvogëlon shpejtësinë e lëvizjes apo ndalet në rrugë në mënyrë të rregullt duke e përshtatur shpejtësinë kushteve dhe rrethanave të krijuara në rrugë. Drejtuesi i automjetit “A” nga pakujdesia dhe mos mbajtja e distancës së nevojshme të sigurisë ndaj automjetit “B” që ishte para tij, me të vërejtur rrezikun nuk arrin të ndalet edhe përkundër përpjekjeve të tij me frenim të vrullshëm, dhe në pamundësi për të evituar aksidentin përplaset në pjesën e prapme të automjetit “B”.

Mendimi i ekspertit është se:

Aksidenti ka ndodhur nga lëshimet e drejtuesit të automjetit “A-Opel” i cili gjatë drejtimit të automjetit nuk ka pasur kujdesin e duhur dhe nuk e ka mbajtur distancën e nevojshme të sigurisë ndaj automjetit para tij, ashtu që në momentin kur automjeti “B” ndalet në rrugë, drejtuesi i automjetit “A” nuk arrin të ndalet dhe përplaset në pjesën e prapme të automjetit “B”.

Gjykata konstatimit dhe mendimit të ekspertit ia dha besimin e plotë dhe e miratoj në tërësi ekspertizën e kryer, meqë e njëjta është e mbështetur dhe argumentuar me prova, e cila ka elemente të mjaftueshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive shkencore e profesionale për vërtetimin e kësaj çështje kontestimore.

Nga prova Raporti Policor numër 2016-AR-... dt.14.07.2016 së bashku me Skicën e vendit të ngjarje numër 2016-AR-.... dt.14.07.2016, gjykata vërtetoi se i padituri ka qenë pjesëmarrës në aksidentin e komunikacionit e cili ka qenë pa policë valide të sigurimit-pa mbulesë siguruese nga auto përgjegjësia, rrjedhimisht dhe pa regjistrim të automjetit, po ashtu nga i njëjti raport vërtetohet se i padituri në momentin e shkakimit të aksidentit nuk kishte patentë shofer.

Nga Ujdi jashtëgjyqësore e lidhur ndërmjet BKS dhe të dëmtuarit E.Gj. e lidhur me datë 25.11.2016, vërtetohet fakti se në mes palës paditëse dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar, av. B. A., është arritur marrëveshja për kompensimin e dëmit të pësuar në aksidentin e trafikut të dt.14.07.2016, sipas së cilës të dëmtuarit në emër të zhdëmtimit duhet ti paguhet shuma e përgjithshme prej 623.00 Euro si dhe shpenzimet e përfaqësimit të avokatit shumë prej 215.00 €.

Nga prova Transferi nga kontoja me numër lëshuar nga Banka Ekonomike me dt.30.12.2016 gjykata vërtetoi faktin se Av. B.. A. (për E. Gj.), i është bërë pagesa e mjeteve në emër të zhdëmtimit në shumën prej 838.00 Euro, në llogarinë e tij.

Nga udhëzimet, konsultat dhe raportet mjekësore të administruara si prova në emër të E. Gj., gjykata ka vërtetuar trajtimet mjekësore të pranuar nga i dëmtuari në qendrat e shërbimeve shëndetësore si pasojë e aksidentit të shkaktuar nga i padituri.

Nga Konfirmimi i Sigurimit TPL:.... dt.14.03.2013, gjykata ka vërtetuar se regjistrimi i fundit që i është bërë automjetit të shkaktarit të aksidentit ka skaduar me datë 13.03.2014, andaj në datën e shkaktimit të aksidentit i padituri nuk kishte mbulesë siguruese.

Nga Transferi nga kontoja me numër lëshuar nga Banka Ekonomike me dt.21.04.2017, gjykata vërtetoi faktin se të dëmtuarit N. F., i është bërë pagesa e mjeteve në emër të zhdëmtimit në shumën prej 1,997.00 Euro, në llogarinë e tij.

Nga Ujdi jashtëgjyqësore e lidhur ndërmjet BKS dhe të dëmtuarit N. F. e lidhur me datë 17.03.2017, vërtetohet fakti se në mes palës paditëse dhe të palës së dëmtuar N. F. është arritur marrëveshja për kompensimin e dëmit të pësuar në aksidentin e trafikut të dt.14.07.2016, sipas së cilës të dëmtuarit në emër të zhdëmtimit duhet ti paguhet shuma e përgjithshme prej 1,977.00 Euro.

Nga Vendim lëshuar nga Policia e Kosovës me numër reference 07/1-01A-..... dt.22.08.2016, gjykata ka vërtetuar si i dëmtuari N. F., si pasojë e aksidentit të shkaktuar nga i padituri, ka marr pushim mjekësor për lëndim në detyrë.

Nga udhëzimet, konsultat dhe raportet mjekësore të administruara si prova në emër të N. F., gjykata ka vërtetuar tretmanet mjekësore të pranuar nga i dëmtuari në qendrat e shërbimeve shëndetësore si pasojë e aksidentit të shkaktuar nga i padituri.

Nga Transferi nga kontoja me numër lëshuar nga Banka Ekonomike me dt.10.07.2017 gjykata ka vërtetuar faktin se të dëmtuarit KS S. (Për Policia e Kosovës), i është bërë pagesa e mjeteve në emër të zhdëmtimit në shumën prej 102.00 euro.

Nga Ujdia Jashtëgjyqësore e lidhur ne mes te BKS dhe Policia e Kosovës nga Prishtina me dt.27.06.2017, vërtetohet fakti se në mes palës paditëse dhe të palës së dëmtuar Policia e Kosovës e përfaqësuar nga i autorizuari KS S., është arritur marrëveshja për kompensimin e dëmit të pësuar në aksidentin e trafikut të dt.14.07.2016, sipas së cilës të dëmtuarit në emër të zhdëmtimit duhet ti paguhet shuma e përgjithshme prej 102.00 Euro.

Nga Fotot e veturës se dëmtuar ne aksidentin e datës 14.07.2016 të shkaktuar nga i padituri, gjykata ka vërtetuar dëmin e shkaktuar në veturën e të dëmtuarit Policia e Kosovës, si pasojë e aksidentit.

Nga Fatura numër 183/08/16 dt.23.08.2016, lëshuar nga PPZ Fatosi, gjykata ka vërtetuar se servisimi i veturës së Policisë së Kosovës PO-116-02, i ka kushtuar të dëmtuarit në shumën prej 119.65 Euro.

Nga Konfirmimi i sigurimit kasko, dt.15.06.2016 deri me dt.14.06.2017, lëshuar nga KS “S.”, gjykata ka vërtetuar se vetura e të dëmtuarit Policia e Kosovës, në momentin e shkakimit të aksidentit nga i padituri, kishte mbulesë siguruese kasko për periudhën nga data 15.06.2016-14.06.2017.

Nga Kërkesa për kompensime (riparim) të demit dt.10.08.2016, gjykata ka vërtetuar se i dëmtuari Policia e Kosovës, kishte drejtuar Kërkesë për kompensim (riparim) të demit në Kompaninë Siguruese “S.”.

Nga Memorandumi Zyrtar dt.28.07.2016, gjykata ka vërtetuar dëmtimin e veturës zyrtare Police-02 i mbështetur edhe nga Memorandumi Zyrtar dt.27.07.2016.

Nga Kallëzim Penal me numër të rastit 2016-AR-... dt.14.07.2016, gjykata ka vërtetuar se ndaj të paditurit ishte ngritur kallëzim penal për veprë penale “Rrezikim i Komunikacionit Rrugor” nga neni 378 par.1 të KPRK-së.

Nga Deklarata e shoferit e dhënë në Policinë e Kosovës me dt.14.07.2016, gjykata ka vërtetuar se se i padituri kishte pranuar se aksidenti ishte shkaktuar si pasojë e pakujdesisë së tij, dhe se automjeti nuk kishte mbulesë siguruese për më shumë se dy vite.

Nga Raporti i oficerit për E. Gj., dt.18.07.2016, Raporti i oficerit për N. F. dt.18.07.2016, Deklarata e Vozitësit N. F. dhe në Policinë e Kosovës dt.16.07.2016, gjykata ka vërtetuar se të dëmtuarit ishin goditur nga automjeti O. C., dhe për pasojë kishin marrë lëndime trupore për çka kanë pranuar tretman mjekësor.

Nga Certifikata e regjistrimit të automjetit CRA... në emër të Polica e Kosovës me targa të regjistrimit numër POLICIA-...-02, Polica e Sigurimit lëshuar nga KS “S.” dt.10.06.2016, gjykata ka vërtetuar se në kohën e shkakimit të aksidentit kishte mbulesë siguruese .

Gjykata shqyrtoi dhe vlerësoi edhe provat tjera për palën e dëmtuar dhe raportet si dhe provat tjera të administruara që gjenden në shkresat e lëndës, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk mund të ndikojnë në vendimin përfundimtar ndryshe të çështjes së ngritur me padi, nga ajo siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke vlerësuar provat, deklaramit të paditëses në padi dhe seancë, si dhe deklarimeve të përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit në të përgjigjur në padi, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, vlerësoi se paditësja ka të drejtë në rimbursimin e demit nga i padituri dhe se ai nuk ka bërë përpjekjen më të vogël ta kompensoi atë, duke mos ofruar kurrfarë provash që të argumentonte të kundërtën e asaj çka pretendon pala paditëse dhe se provat e ofruara nga pala

paditëse e bindën gjykatën se vërtetë ajo ka të drejtë në thëniet e saja dhe se kërkesëpadia e saj është e bazuar, duke i bërë të besueshme pretendimet.

Përkundër kësaj gjendje faktike të vërtetuar në procedurën me prova i padituri nuk e ka bërë rimbursimin e dëmit dhe për shkak të mos rimbursimit të dëmit, ka hyrë në raporte detyrimore me paditësen, në të cilin raport paditësja e ka cilësinë e kreditorit, kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Sipas dispozitave të nenit 8 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), është përcaktuar se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.”*

Me dispozitat e nenit 245 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, është paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Meqë në rastin konkret u vërtetua se i padituri ka mbetur në borxh ndaj paditëses, e i cili borxh u vërtetua se konsiston në shumën prej 2,917.00 Euro. Pasi që të dëmtuarve i është bërë pagesa e dëmit të pësuar në aksident trafiku të shkaktuar nga i padituri, i padituri nuk i ka kthyer respektivisht nuk ka bërë rimbursimin e dëmit në shumën e kërkuar. Atëherë, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartcekura në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurin që paditëses t’ia kompensojë dëmin konform dhe dispozitave të nenit 14 par.1 nën par.1.2 dhe par.3 me të cilin përcaktohet se: *“I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur:, 1.2 drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimave të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimimit; ndërsa paragrafi 3 përcakton Siguruasi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.”*, lidhur me nenin 13, si dhe neneve 29 par.1 dhe 6, nenit 32 par.3 nën par.3.1 të Ligjit Nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, në emër të rimbursimit të dëmit këtë shumë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kamatën që e njëjta të paguhet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi i është llogaritur konform nenit 382 të LMD-së, por iu refuzua kërkesa e palës paditëse që kamata të jetë nga dita e ngritjes së padisë si e pabazuar sepse i padituri me ditën e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e ka kuptuar për dëmin e shkaktuar dhe lartësinë e tij.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore u mor konform dispozitave të nenit 449.1, 452 dhe 453.1 të LPK-së, si dhe Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, duke obliguar të paditurin që në bazë të suksesit të paditëses në kontest e që e njëjta pati sukses në tërësi, të njëjtës t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 460.40 eurove, dhe atë në emër të taksës gjyqësore të paguar për padi në shumë prej 40.00 Euro, shumën prej 150.00 euro për ekspertizë të komunikacionit, si dhe shpenzimet

Numri i lëndës: 2019:192534
Datë: 18.09.2024
Numri i dokumentit: 06178381

për përfaqësuesin e përkohshëm në total prej 270.40 eurove dhe atë për përfaqësim në dy seanca shumë prej nga 135.20 €, në shumë prej 270.40 Euro.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.296/2019, me datën 05.09.2024**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.